VENDIM
Nr. 75, datë 22.4.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "SPAHIU GJANÇ" SHPK, PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ANA E ERE-s, PËR LËNIEN PENG TË KUOTAVE

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të pikës 5.2 të "Licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike", të pikës 6.2 të "Licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë "Spahiu Gjanç" sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, për lënien peng të kuotave,

konstatoi se:

- Shoqëria "Spahiu Gjanç" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 11, seria PV03K, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 20, datë 19.12.2003, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Gjanç", me kapacitet të instaluar 3.7 mw, për një afat 30-vjeçar, si dhe të licencës nr. 224, seria T14P, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 14, datë 3.3.2014, të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 20-vjeçar.

- Shoqëria "Spahiu Gjanç" sh.p.k., me shkresën protokolluar në ERE me numrin 87/1 prot., datë 23.1.2020, shkresën nr. 87/3 prot., datë 17.2.2020, dhe me shkresën e dërguar me komunikim elektronik në datën 9.4.2020, protokolluar në ERE me nr. 86/5 prot., datë 14.4.2020, ka depozituar dokumentacion dhe informacion shtesë, në lidhje me kërkesën për marrjen e autorizimit të ERE-s, për vendosjen e pengut mbi kuotat e shoqërisë.

- Kërkesa e shoqërisë për pajisje me autorizim nga ana e ERE-s vjen në zbatim të pikës 6.2 të licencës, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe të pikës 5.2, të "Licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike".

- Shoqëria ka paraqitur në ERE vendimin nr. 5194 rep. dhe nr. 758 kol., datë 20.12.2019, të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Spahiu Gjanç" sh.p.k., si dhe shkresat drejtuar MIE-s (Ministria e Industrisë dhe Energjisë) dhe MBZHR-së (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural), në lidhje me njoftimin për aplikimin dhe marrjen e një kredi bankare.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE kontratën e kredisë bankare, nr. 3699 rep., nr. 1304 kol., datë 20.12.2019, lidhur ndërmjet "Intesa San Paolo Bank" sh.a. (Banka) dhe shoqërisë "Spahiu Gjanç" sh.p.k. (Kredimarrësi), ku parashikohet detyrimi i shoqërisë për të paraqitur jo më vonë se muaji mars 2020 miratimin/autorizimin e nevojshëm me shkrim lëshuar nga ERE (Enti Rregullator i Energjisë") lidhur me pengjet/barrët siguruese të radhës së parë që do të vendosen mbi kuotat e shoqërisë koncesionare, me qëllim garantimin e të gjitha detyrimeve të rrjedhura për kredimarrësin prej kontratës së kredisë.

- Me shkresën nr. 87/2 prot., datë 11.2.2020, ERE i ka kërkuar shoqërisë "Spahiu Gjanç" sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën për cedim kuote nr. 2726 rep., 492 kol., datë 8.8.2019; kontratën për cedim kuote nr. 3452 rep., 576 kol., datë 20.9.2019; si dhe kontratën për shitblerje kuotash me nr. 3453 rep., 575 kol., datë 20.9.2019, që listohen në kontratën e kredisë nr. 3699 rep., nr. 1304 kol., datë 20.12.2019, me qëllim qartësimin e të gjitha lëvizjeve dhe veprimeve që janë kryer për transferimin e kuotave dhe për të kuptuar sa më qartë të drejtat dhe detyrimet që lindin nga këto kontrata.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE kontratën për cedim kuote nr. 2726 rep., nr. 492 kol., datë 8.8.2019; kontratën për cedim kuote nr. 3452 rep., 576 kol., datë 20.9.2019; si dhe kontratën për shitblerje kuotash me nr. 3453 rep., 575 kol., datë 20.9.2019.

- ERE i dërgoi shoqërisë njoftimin nr. 538 prot., datë 27.2.2020, për zhvillimin e një seance dëgjimore, me qëllim marrjen e shpjegimeve të nevojshme, n lidhje me hapat proceduralë të ndjekur nga shoqëria për marrjen e kësaj kredie.

- Për shkak të marrjes së masave shtrënguese nga qeveria shqiptare, me qëllim parandalimin e përhapjes së epidemisë COVID-19, rezultoi e pamundur të zhvillohej një seancë dëgjimore me aplikuesin.

- Me komunikimin elektronik të datës 9.4.2020, protokolluar në ERE me nr. 86/5 prot., datë 14.4.2020, shoqëria ka dhënë shpjegime të zgjeruara në lidhje me sa kërkohej nga ERE.

- Aplikuesi ka bërë me dije, se kredia bankare, për të cilën kërkohet nga ERE autorizimi për lënien peng të kuotave të shoqërisë, ka si objekt ripagimin e ortakut, që do të thotë rikthimin e detyrimit të financimit që shoqëria koncesionare "Spahiu Gjanç" sh.p.k. ka përkundrejt ortakut të vetëm, shoqëria "Hydro Invest" sh.p.k.

- Me lënien peng të kuotave, shoqëria ekspozohet ndaj një ndryshimi potencial të aksionarit, në rrethanat e pamundësisë likuiduese për të shlyer kredinë e në këto kushte ndodhet në rrethanat e parashikuara në pikat 6.2 të licencës, "Për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike" dhe të pikës 5.2, të "Licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike", objekt i shqyrtimit e autorizimit nga ERE.

- Shoqëria "Spahiu Gjanç" sh.p.k. ka kryer pagesat e rregullimit dhe nuk është debitore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s, për lënien peng në favor të Bankës Intesa San Paolo Bank sh.a. të kuotave të shoqërisë "Spahiu Gjanç" sh.p.k., që zotërohen 100% nga shoqëria "Hydro Invest" sh.p.k.

2. Shoqëria të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të kredisë dhe heqjen e pengut mbi kuotat.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti